

Hurshid Ahmed

I S L A M I

Parimet dhe veçoritë kryesore

Kreuzlingen, Zvicër - 2003

Në emër të All-llahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit

Titulli origjinal:

ISLAM - Basic Principles and Characteristics

Nga anglishtja:

Mr. Rejhan Neziri

Parathënie

Mesazhi i Islamit është i thjeshtë dhe i plotë: t'ia nënshtrosh vetveten tërësisht Zotit dhe Krijuesit, Një Zoti të Vërtetë. Formula e tij për suksesin dhe zhvillimin është e qartë dhe e shkurtër: beso sinqerisht dhe zbukuroje jetën tënde me vepra të drejta e të ndershme! Besimi i drejtë nënkupton besimin në njëshmërinë e Zotit dhe në sovranitetin e Tij të vetëm, besimin në të gjithë pejgamberët e Tij duke përfshirë edhe atë të fundit, Muhammedin a.s., besimin në Librat e shpallur, besimin në engjujt (*melekët*) si dhe besimin në Ringjalljen pas vdekjes dhe marrjen në llogari për punët e kësaj bote. Një jetë veprash të drejta e të ndershme është jeta me adhurime, shërbime dhe realizime të aftësive. Bazat dhe burimi i fuqisë së veprave të drejta janë pesë: *namazi* i rregullt, *agjërimi*, *zekati* e lëmosha, *haxhi* si dhe *lufta* për kauzën e së vërtetës për të ngritur një shoqëri të mëshirshme e të drejtë. Rezultati i natyrshëm i një jete veprash të drejta e fisnike është përkryerja e shkallëshkallshme e individit dhe e shoqërisë.

Për ata që e pranojnë këtë porosi, Islami premtos shpërblim të madh për në këtë botë dhe akoma më të madh për në botën që do të vijë. Ai premtos qetësi shpirtërore, harmoni me natyrën, lumturi për individët dhe ngritje e sukses material për shoqëritë që e plotësojnë urdhrin moral për kryerjen e punëve të drejta e të ndershme. “All-llahu u ka premtuar atyre nga mesi juaj që besojnë dhe që punojnë mirësi e drejtësi, se Ai patjetër do t’u sigurojë atyre vazhdimësinë në tokë”, (Kur’ani, 24:55). Ndërkaq, shpërblimi më i madh është rezervuar për në Botën tjetër (*Ahiretin*): “Askush nuk e di se çfarë është ruajtur për ta nga kënaqësitë e syrit si shpërblim për çfarë ata punuan”, (Kur’ani, 32:17).

Libërthi *Islami: parimet dhe veçoritë kryesore* mëton të jetë njëra prej hyrjeve më të mira të shkurta në porosinë bazë dhe në veçoritë qenësore të Islamit. Autori, Hurshid Ahmed, është një dijetar eminent dhe lider i spikatur i Lëvizjes islame në vendlindjen e tij në Pakistan dhe në Perëndim. Në këtë libërth ai në mënyrë të thuktë përfshinë kompleksitetin e mendimit islam në një mënyrë të qartë e bindëse. Shpresojmë që ky libërth të jetë joshës dhe i dobishëm për lexuesit!

Ihsan Bagby
Drejtore i Islamic Education
Islamic Teaching Center
6 mars 1989 / 27 rreth 1409
Indiana, SHBA

Përmbajtja:

Parathënie	III
Përmbajtja.....	IV
ISLAMI: PARIMET DHE VEÇORITË KRYESORE	1
KUPTIMI I ISLAMIT	1
<i>TEWHIDI</i> – GURËTHEMELI I ISLAMIT	3
PEJGAMBERIA DHE JETA PAS VDEKJES	4
DISA VEÇORI BAZË TË IDEOLOGJISË ISLAME	6
1. Thjeshtësia, racionalizmi dhe praktikizmi.....	6
2. Uniteti i materies dhe shpirtit	7
3. Një mënyrë e tërësishme jete	8
4. Baraspesha midis individit dhe shoqërisë	9
5. Universaliteti dhe humanizmi	11
6. Qëndrimi antiracist i Islamit.....	11
7. Qëndrueshmëria dhe ndryshimi	12
8. Ruajtja e regjistrimit të tërësishëm të mësimëve.....	13

ISLAMI: PARIMET DHE VEÇORITË KRYESORE

Islami është feja e së vërtetës. Ai është mishërim i kodit të jetës të cilin All-llahu, Krijuesi dhe Zoti i gjithësisë, e ka shpallur për përudhjen e njerëzimit.

Për zhvillimin normal të jetës njeriu ka nevojë për dy lloje gjërash: a) burimet për mbajtjen dhe ruajtjen e jetës si dhe për përmbushjen e nevojave materiale të individit e të shoqërisë, dhe b) njohjen e parimeve të sjelljes individuale dhe shoqërore për t'ia mundësuar njerëzimit vetëkënaqjen dhe ruajtjen e drejtësisë e të qetësisë. Të dyja këto Zoti i gjithësisë i ka dhënë në masë të plotë. Për t'i kënaqur nevojat materiale të njeriut Ai e ka furnizuar natyrën me të gjitha llojet e resurseve dhe i ka lënë në disponimin e njeriut. Për t'i kënaqur nevojat shpirtërore, shoqërore dhe kulturore të tij, Zoti, nga mesi i njerëzve i ka zgjedhur peygamberët (profetët) e Tij dhe u ka shpallur atyre kodin e jetës i cili mund t'i udhëzojë hapat e njeriut drejt Rrugës së Vërtetë. Ky kod njihet me emrin Islam, që është feja e predikuar nga ana e të gjithë peygamberëve të All-llahut xh.sh.¹

All-llahu xh.sh. thotë: “Ju (muslimanë) thuani: ‘Ne besojmë All-llahun dhe atë që na është dërguar neve dhe atë që i është zbritur Ibrahimit edhe Ismailit edhe Is’hakut edhe Jakubit edhe pasardhësve të tij edhe atë që i është dhënë Musait edhe Isait edhe atë çfarë u është dhënë të gjithë peygamberëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë asnjë dallim mes tyre dhe Vetëm Atij ne i jemi nënshtruar (si muslimanë)’”, (Kur’ani, 2:136, po ashtu 3:84).

Po kështu: “Është Ai i Cili të ka zbritur ty (o Muhammed) Librin (Kur’anin) me të vërtetën, duke vërtetuar çfarë ka zbritur para tij. Dhe Ai ka zbritur edhe Tevratin dhe Inxhilin kohë më parë, si udhëheqje për njerëzimin. Dhe Ai zbriti edhe Kriterin (e gjykimit mes së mirës dhe së keqes – Kur’anin)”, (Kur’ani, 3:3-4).

Të gjithë peygamberët e kanë thirrë njerëzimin për në rrugën e Zotit, për në rrugën e përkuljes ndaj All-llahut xh.sh. Të gjithë ata e kanë dhënë të njëtin mesazh, të gjithë ata e kanë mbrojtur të njëjtën kauzë, Islamin.

KUPTIMI I ISLAMIT

Islami është një fjalë arabe dhe shënon pranimin e All-llahut xh.sh. si Realitet Suprem dhe Final. Kjo nënkupton nënshtrim, përkushtim dhe bindje. Si fe, Islami angazhohet për nënshtrimin dhe bindjen e plotë të njerëzve ndaj All-llahut xh.sh.² – kjo është arsyeja përse ai

¹ Kur’ani thotë: “Ai (All-llahu) ka përcaktuar e urdhëruar për ju të njëjtën fe të cilën Ai e pati urdhëruar për Nuhun, dhe atë të cilën Ne ta kemi frymëzuar ty (O Muhammed) dhe atë të cilën Ne e urdhëruam për Ibrahimin, Musain dhe Isanë duke thënë që ju të vendosni (zbatoni) fenë dhe të mos bëni ndarje në të”, (Kur’ani, 42:13).

² Fjala Islam rrjedh prej rrënjës **s-l-m** (e shqiptuar **silim**) që nënkupton a) dorëzim, nënshtrim, përkulje, përkushtim, andaj thuhet *esleme emrahu ilall-llah* që do të thotë ‘ia dorëzoi çështjen e vet Zotit’ ose ‘ia dorëzoi vetveten vullnetit të Zotit’. Vetëm fjala *esleme* do të nënkuptojë ‘i është nënshtruar vullnetit të Zotit’ ose ‘është bërë musliman’. Ngjyrimi tjetër kryesor i kuptimit të rrënjës është b) ‘të jesh i pajtuar me njëri-tjetrin, të bësh paqe’. *Selm* do të thotë ‘paqe’, po kështu edhe fjala *silim*, që gjithashtu do të thotë edhe ‘feja islame’. Shih Hans Wehr, *A Dictionary of Modern Written Arabic*, Wiesbaden: Otto Harrassowitz, 1971, f. 424-425. Imam Ragib (el-Isfahani) në veprën e tij *Mufridat fi Garibi'l-Kur'an* thotë: “Nga aspekti i së drejtës Islami është dylojsh: njëri është deklaram a rrëfim i thjeshtë me gojë...kurse tjetri ka të bëjë me besimin që është në zemër, me

quhet *Islam*. Kuptimi tjetër i mirëfilltë i fjalës Islam është “paqe” dhe kjo shënon faktin se njeriu mund ta arrijë paqen / qetësinë e trupit e të mendjes a shpirtit vetëm nëpërmjet nënshtrimit dhe bindjes ndaj All-llahut xh.sh. Një jetë e këtyre e bindjes sjell qetësinë e zemrës dhe krijon paqen e vërtetë shoqërore në përgjithësi.

“Ata që besuan dhe zemrat e të cilëve gjejnë prehje duke përkujtuar All-llahun: Nuk ka dyshim se në përkujtimin e All-llahut vërtet që zemrat gjejnë prehje. Ata që besojnë dhe punojnë me drejtësi, lum për ata dhe ata do të kenë një vendkthim të mirë, të bukur”, (Kur’ani, 13:28-29).

Përkundër shumë feve të tjera, emri Islam nuk lidhet as me themeluesin e tij (si në Budizëm apo Krishterizëm), as me fisin apo racën (si në Hebraizëm/Judaizëm) po as me tokën apo dheun (si në Hinduizëm).

Cilido që t’i përkulet All-llahut xh.sh., si Krijuesit të gjithësisë (universit), është musliman potencial (i mundshëm).

Islami është emri që i është dhënë këtij besimi nga ana e All-llahut, Krijuesit, në shkrimin e Tij të shpallur, në Kur’an...”Këtë ditë Unë e përsosa fenë tuaj për ju, e plotësova mirësinë Time mbi ju dhe zgjedha për ju Islamin si fe”, (Kur’ani, 5:3).

Sipas Kur’anit, ky mesazh është predikuar nga të gjithë peygamberët e Zotit, të cilët njerëzimin e kanë përudhur në rrugën e drejtë. Mirëpo, njerëzimi jo vetëm që është larguar prej rrugës së drejtë përsëri e përsëri, por edhe e ka humbur apo shtrembëruar kodin e udhëzimit që e kishin lënë trashëgim peygamberët. Kjo është arsyeja përse janë dërguar peygamberët e tjerë njëri pas tjetrit për ta rikthyer mesazhin (porosinë) origjinal dhe për t’i drejtuar njerëzit në udhën e vërtetë. I fundit prej këtyre peygamberëve ishte Muhammedi (paqa qoftë mbi të!), i cili udhëzimin e Zotit e ka prezentuar në formën finale dhe është zotuar se Zoti do ta ruajë atë për gjithë kohërat. Ky është ai udhëzim e përudhje që tani njihet si *el-Islam* dhe që është ruajtur në Kur’an dhe në jetën shembullore të Peygamberit, Muhammedit a.s.

Koncepti bazë i Islamit është se mbarë gjithësia është e krijuar nga Zoti, të Cilin Islami e quan *All-llah* dhe i Cili është Zoti dhe Sovrani i gjithësisë. Ai është Zoti i gjithësisë të cilën Ai e mban Vetë. Ai e ka krijuar njerëzimin dhe çdo qenieje njerëzore i ka caktuar një periudhë të prerë jete të cilën ai duhet ta kalojë mbi faqen e dheut. All-llahu xh.sh. ka përshtatur një kod të caktuar jete si të përshtatshëm për njeriun dhe në të njëjtën kohë ia ka dhënë atij lirinë e zgjedhjes që ta përvetësojë ose jo këtë kod si bazë aktuale të jetës së tij. Ai që zgjedh ta ndjekë kodin e shpallur nga Zoti bëhet *musliman* (besimtar; i nënshtruar), kurse ai që refuzon ndjekjen e tij bëhet *qafir* (mosbesimtar).

Njeriu i bashkohet grigjës së Islamit me krenari duke besuar dhe pranuar haptas besimin në njëshmërinë e Zotit dhe në peygamberinë e Muhammedit (paqa qoftë mbi të!). Të dyja këto besime janë të përmbledhura e të mishëruara në *Kelime-i Shehadetin* (Fjalën e Dëshmisë):

Lā ilāhe il-lall-llāh, Muhammed resūlull-llāh

(S’ka zot tjetër pos All-llahut, Muhammedi është i dërguar i Tij).

Pjesa e parë e kësaj Fjale paraqet konceptin e *Tewhidit* (njëshmërisë së Zotit), kurse pjesa e dytë afirmon peygamberinë e Muhammedit (paqa qoftë mbi të!).

plotësimin e tij në praktikë dhe me nënshtrimitin ndaj Zotit për gjithçka që Ai ka porositur apo ndaluar”. Më tej Ragibi thotë: “Islami nënkupton futjen në *selm*, kurse *selm* dhe *silm* të dyja shënojnë ‘paqen’”.

***TEWHIDI** – GURËTHEMELI I ISLAMIT**

Tewhidi është një parim revolucionar dhe përbën thelbin e mësimëve të Islamit. Kjo fjalë nënkupton se ekziston vetëm Një Zot Suprem i gjithësisë. Ai është i Gjithfuqishëm, i Gjithdijshtëm dhe Furnizues e Mbajtës i botës dhe i njerëzimit.

Si mund njeriu ta vrojtojë (kundrojë) kreativitetin e pashtershëm të natyrës, qëllimshmërinë e saj, ruajtjen e asaj që moralisht është e dobishme dhe shkatërrimin e asaj që nga aspekti shoqëror është e dëmshme dhe akoma të mos mund të arrijë në përfundimin se prapa natyrës gjendet një Mendje e Gjithanshme, që për veprimtarinë e vazhdueshme krijuese të së cilës proceset e natyrës paraqesin vetëm një manifestim të jashtëm? Yjet e shpërhapura nëpër hapësirën pothuajse të pafund, panorama e gjerë e natyrës me joshën dhe bukurinë e saj, zmadhimi dhe thyerja (vdirja) e planifikuar e hënës, harmonia e çuditshme e sezonave – të gjitha këto tregojnë të njëjtin fakt: ekzistencën e Zotit, Krijuesit, Zotëruesit. Jemi dëshmitarë të një plani madhështor e të pacen që ndodhet në gjithësi – a mund të mos e ketë Planifikuesin e vet? Shohim bukurinë dhe harmoninë e madhe magjepsëse të punës së saj – a mund të mos e ketë Krijuesin e vet? Kundrojmë dizajnin e mrekullueshëm në natyrë – a mund të mos e ketë Dizajnuesin e vet? Ndjejmë një qëllim të lartë e fisnik në ekzistencën fizike dhe njerëzore – a mund të ndodhë kjo pa një Vullnet që vepron pas tij? Ne shohim se gjithësia është sikur një roman fascinues i shkruar në mënyrë madhështore – a mund të mos e ketë Autorin e saj? Vërtet, All-llahu xh.sh. thotë:

“O njerëz! Adhuroni All-llahun, Zotin tuaj, i Cili ju krijoi juve dhe ata që qenë para jush, që të mund të bëheni të përkushtuar. I Cili e ka bërë tokën vend pushimi për ju dhe qiellin me kube si mbulesë duke dërguar që andej ujë për të prodhuar fruta si furnizim për ju. Atëherë pra, mos i vini shokë All-llahut (në adhurim) kur ju e dini (se vetëm Ai ka të drejtë të adhurohet)”, (Kur’ani, 2:21-22).

Kjo është doktrina bazë në të cilën Muhammedi a.s. e ka ftuar njerëzimin për ta ndjekur.

Ky është një realitet i rëndësishëm metafizik dhe i shpjegon enigmat e gjithësisë. Ai e thekson epërsinë e ligjit në kozmos, njëjtesinë e gjithanshme që qëndron pas llojllojshmërisë së dukshme.

Ai paraqet një botëshikim të njësuar që ofron vizionin e një gjithësie të integruar. Ky është një kontrast i madh me shikimet e copëzuara të shkencëtarëve e të filozofëve dhe të vërtetës ia heq velon (e zbulon) përpara syve të njeriut. Pas shekujve të qorrollatjes nëpër terr, njerëzimi tani po e kupton të vërtetën e këtij koncepti, kurse mendimi bashkëkohor shkencor po lëviz drejt kësaj kahjeje.³ Mirëpo, ky nuk është vetëm një koncept metafizik. Ky është edhe një besim dinamik dhe një doktrinë revolucionare. Kjo nënkupton se të gjithë njerëzit janë krijesa të një Zoti – ata janë të gjithë të barabartë. Diskriminimi i bazuar në ngjyrën, klasën, racën a territorin është i pabazë dhe iluzor; ai është një mbeturinë e ditëve të injorancës që njerëzit i lidh për skllavërinë. Njerëzimi është një familje e vetme e Zotit dhe s’mund të miratohen pengesat e tilla. Njerëzit janë një – dhe jo borgjezë a proletarë, të bardhë a të zinj, arianë a joarianë, perëndimorë a lindorë. Islami sjell konceptin revolucionar të njëshmërisë së njerëzimit.

* Për kuptimin dhe reflektimin e *Tewhidit* në jetën individuale, shoqërore, kulturore, etike, psikologjike, metafizike, politike, ekonomike, familjare, estetike etj. , më gjerësisht shih veprën e Ismail Raxhi el-Farukit: *Al-Tawhid – Its Implications for Thought and Life*, të cilën unë (Rejhan Neziri) e kam përkthyer në gjuhën shqipe dhe e cila së shpejti pritet të botohet.

³ Shih Francis Mason (ed.), *The Great Design*, Londër: Duckworth.

Pejgamberi a.s. ka ardhur ta bashkojë njerëzimin rreth fjalës së Zotit dhe t'i japë asaj një jetë të re. All-llahu xh.sh. thotë:

“Dhe mbahuni fort të gjithë ju së bashku pas Litarit të All-llahut (Kur'anit) dhe mos u ndani mes jush dhe mbani në mendje mirësinë e All-llahut përmbi ju kur ju qetë armiq mes njëritjetrit dhe Ai bëri bashkimin mes zemrave tuaja, kështu që me mirësinë e Tij u bëtë vëllezër”, (Kur'ani, 3:103).

Kjo, mbase, e përkufizon pozitën e vërtetë të njerëzimit në gjithësi. Kjo nënkupton se Zoti është Krijuesi, Sovrani dhe se njerëzimi është mëkëmbës i Tij në tokë.⁴ Kjo e lartëson njeriun në një pozitë fisnike e dinjitoze si një i deleguar i Zotit në tokë dhe i dhuron jetës së tij një qëllim të lartë: që në tokë ta përmbushë Vullnetin e Zotit. Kjo i zgjidh të gjitha çështjet e ngatërruara të shoqërisë njerëzore dhe krijon një rend të ri ku barazia, drejtësia, paqa dhe prosperiteti do të mbeten supreme.

Pika nisëse e Islamit është ky besim në Njëjësinë e Zotit (*Tewhidin*).

PEJGAMBERIA DHE JETA PAS VDEKJES

Pjesa e dytë e *Shehadetit*, së këndejmi, shënon se Zoti nuk e ka lënë njerëzimin pa ndonjë udhëzim për drejtimin e jetës së tij. Ai, Udhëzimin e Tij e ka shpallur (zbuluar) nëpërmjet pejgamberëve të Tij, kurse Muhammedi a.s. ka qenë Pejgamber i fundit. Dhe, të besosh një pejgamber do të thotë t'i besosh porosisë së tij, ta pranosh Ligjin që e sjell ai dhe ta ndjekësh Kodin e sjelljes që ta mëson ai.

Kështu, pra, postulati i dytë bazë i Islamit është të besosh në pejgamberinë e Muhammedit a.s., ta pranosh fenë që e ka prezentuar ai dhe t'i ndjekësh urdhrat e tij.

Sipas Kur'anit, çdo pejgamber i Zotit është munduar që marrëdhëniet e njeriut me Zotin t'i ndërtojë mbi parimin e epërsisë së Zotit dhe mbi njohjen e autoritetit të pejgamberit si burim i udhëzimit hyjnor. Secili prej tyre ka thënë: “Vërtet unë jam i dërguar besnik i Zotit për te ju. Kijeni, pra, frikë All-llahun, plotësoni detyrimin tuaj ndaj Tij dhe bindmuni mua!”⁵

Udhëzimi është shpallur nëpërmjet pejgamberëve. Ka qenë pjesë e misionit të tyre që atë ta shndërrojnë në praktikë në jetën e tyre si dhe në shoqërinë që synonin ta reformonin. Të gjithë pejgamberët janë reprezentues (përfaqësues) të Zotit, mirëpo ata janë qenie njerëzore dhe jeta e tyre është model për njerëzimin. Muhammedi a.s. është pejgamberi i fundit dhe si i tillë është modeli final për njerëzimin. T'i besosh atij do të thotë ta pranosh autoritetin e tij si përfaqësues të Drejtuesit Suprem dhe ta ndjekësh shembullin e tij në mendime e sjellje. Kodi i sjelljes, ligji që vendos se ç'është e lejueshme e çka jo (*hallall* dhe *haram*), është i dhënë nga ana e Zotit nëpërmjet pejgamberit dhe njihet me emrin *Sheri'at*. Besimi në pejgamberin përfshinë pranimin e *Sheri'atit*, Rrugës, që e ka përcjellur ai dhe implementimin e tij në të gjitha fushat e jetës. Kjo është mënyra se si përmbushet e realizohet Vullneti i Zotit në tokë.⁶ Kur'ani thotë:

⁴ Kur'ani, 2:30-39.

⁵ Kur'ani, 26:107-108; 110; 125-126; 131; 143-144; 150; 162-163; 178-179.

⁶ Jezusi (Isai a.s.), ashtu si edhe pejgamberët e tjerë, e ka prezentuar të njëjtin mesazh. Kjo është ajo çka synon ai, kur thotë: “Ardhtë mbretëria Jote – u bëftë vullneti Yt si në qiell, ashtu edhe në tokë!”, *Bibla – Dhiata e Re*, Mateu, 6:10-11.

“Ne nuk kemi sjellë asnjë të Dërguar për diç tjetër, por vetëm t’u dëgjohet fjala me lejen dhe urdhrin e All-llahut”, (Kur’ani, 4: 64).

Kurse për peygamberin e fundit ai thotë qartë:

“Por jo, për Zotin tënd! Ata nuk mund të kenë aspak besim përderisa të të bëjnë ty (o Muhammed) gjykues për të gjitha mosmarrëveshjet mes tyre, derisa të mos mbetet në veten e tyre asnjë pikë kundërshtimi ndaj vendimeve tua dhe derisa t’i pranojnë ato (vendimet tua) plotësisht të nënshtruar”, (Kur’ani, 4:65).

Dëshmia për pranimin apo njohjen e Zotit dhe të Peygamberit të Tij, qëndron në drejtimin e të gjitha punëve njerëzore sipas Ligjit që e kanë përcjellur ata.

“Kushdo që nuk gjykon me atë që ka shpallur All-llahu (me Ligjin e All-llahut), të këtillët janë mosbesimtarë”, (Kur’ani, 5:44).

Prandaj, besimi në Zotin dhe në Peygamberin e Tij nënkupton zotimin për t’u bindur atyre dhe për ta modeluar jetën individuale dhe kolektive në dritën e Ligjit e të Udhëzimit që e kanë sjellur ata.

Kjo drejtpërdrejtë e nxit pyetjen: A do të jenë të një niveli të ekzistencës ata që e ndjekin ligjin dhe ata që refuzojnë ta pranojnë apo t’i përmbahen atij? A do të trajtohen këta njësoj apo ndryshe-ndryshe? Ç’do të ishin pasojat e qëndrimeve dhe sjelljeve të ndryshme?

Kjo ne na çon te postulati i tretë i Islamit: besimi në botën e paskëtajshme.

Bota, sipas Islamit, është një vend prove ku njerëzimi po sprovohet. Ai do të duhet të japë llogari për gjithë atë që e bën. Jetës në tokë, një ditë, do t’i vijë fundi dhe pastaj do të ringjallet një botë e re. Do të jetë kjo Jeta e pasvdekjes ku njeriu do të shpërblehet apo dënohet për veprat e tij të mira e të liga. Ata që në këtë botë bëjnë një jetë të nënshtruar ndaj Zotit, në botën tjetër do ta shijojnë lumturinë e përgjithmonshme, kurse ata që s’u binden urdhrave të Tij do t’i mbledhin frytet e hidhura të mosnënshtrimit të tyre. Sipas Kur’anit:

“Dhe çdo njeriu ia kemi lidhur fort pas qafe veprat e tij dhe Ditën e Kijametit Ne do t’ia nxjerrim atij shkresën të shtrirë gjerë e gjatë përpara tij. (Do t’i thuhet): ‘Lexoje librin tënd! Ti vetë je i mjaftueshëm këtë Ditë si gjykues kundër vetes tënde’”, (Kur’ani, 17:13-14).

“Kushdo që sjell një vepër të mirë do të ketë në llogari të tij dhjetëfishin e saj, ndërsa kushqo që sjell një vepër të keqe do të ketë shpërblim (ndëshkim) vetëm për atë që ka bërë. Dhe atyre nuk do t’u bëhet padrejtësi”, (Kur’ani, 6:160).

Elementet bazë të besimit në Islam, përveç *tewhidit* (njëjësisë dhe mëvetësisë së All-llahut xh.sh.), *nubuvvetit* (peygamberisë) dhe *ahiretit* (jetës së paskëtajshme), përfshijnë edhe besimin e ekzistimit të engjijve (melekëve), të shkrimeve të shpallura më herët si dhe fatin e mirë e të keq nga All-llahu xh.sh.. *Shehadeti* (deklarimi i besimit): “Nuk ka zot tjetër pos All-llahut xh.sh. dhe Muhammedi është Peygamber i Tij”, nënkupton një pranim e njohje të vetëdijshme e të vullnetshme të këtyre çështjeve thelbësore të besimit.

DISA VEÇORI BAZË TË BOTËKUPTIMIT ISLAM

Islami bart një mesazh për çdo qenie njerëzore. E vërteta e tij e thellë, thjeshtësia e dukshme dhe rëndësia që ka për çdo moshë, e bën atë një mënyrë jetese unike për mbarë njerëzimin. Ndoshta kjo është arsyeja përse kritiku bashkëkohor parashikon: “Parashikoj që besimi i Muhammedit do të mund të pranohet nga Evropa e nesërme ashtu siç ka filluar të pranohet nga Evropa e sotme”.⁷

Pyetja është se cilat janë ato veçori të Islamit që i kanë pushtuar e bindur miliona ndjekës të fesë në të kaluarën dhe që e bëjnë atë aq joshës për kohërat moderne? Disa nga veçoritë kryesore të Islamit do të jepen në faqet në vijim.

Thjeshtësia, racionalizmi dhe praktikizmi

Islami është një fe pa kurrfarë mitologjie. Mësimet e tij janë të thjeshta e të kuptueshme. Ai nuk ka bestytni e besime irracionale. Njëjësia e Zotit, pejgamberia e Muhammedit a.s. dhe koncepti i jetës pas vdekjes janë elementet bazë të besimit të tij. Ato mbështeten në arsyen dhe në logjikën e shëndoshë. Të gjitha mësimet e Islamit rrjedhin nga këto besime bazore dhe janë të thjeshta e të qarta. Nuk ka hierarki shenjtorësh, as abstraktime të pabesueshme e as rite e rituale të komplikuar. Çdokush mund t’i qaset Librit të Zotit (Kur’anit) drejtpërdrejtë dhe diktatet e tij t’i shndërrojë në praktikë.

Islami e zgjon te njeriu aftësinë e të menduarit dhe e shtyt atë që ta përdorë intelektin. Ai kërkon prej njeriut që gjërat t’i shohë nën dritën e realitetit. Kur’ani këshillon njerëzimin që të lutet: “O Zotë im! Shtoma diturinë!”, (Kur’ani, 20:114). Ai vë në dukje se njeriu që nuk vështron përreth dhe nuk kupton është më i keq se bagëtia (Kur’ani, 7:179); se kuptimet e Shpalljes u shfaqen atyre “që kanë dije” (Kur’ani, 6:97) dhe “që kuptojnë” (Kur’ani, 6:98); se “kujt i është dhënë dija (urtësia) atij i është dhënë një mirësi e madhe” (Kur’ani, 2:269); se ndër kualifikimet kryesore që duhet t’i ketë udhëheqësi (i shtetit, etj.), ndër të tjerat, është edhe dituria dhe shëndeti fizik (Kur’ani, 2:247) dhe se mbi të gjitha për hir të dijes që ka, njeriu është superior mbi engjujt dhe është bërë mëkëmbës i Zotit në tokë (Kur’ani, 2:30). Pejgamberi i Islamit ka thënë:

“Ai që e lëshon shtëpinë për të kërkuar dijen, ai ec në rrugën e Zotit”.

“Kërkimi i diturisë është obligim për çdo musliman”.

“Kërkoje diturinë, sepse ai që e kërkon atë në rrugë të Zotit ka kryer një akt përkushtimi; ai që e përhap atë ka dhënë lëmoshë, kurse ai që e bart atë te të tjerët ka kryer një akt përluljeje ndaj All-llahut xh.sh.”.

Kjo është mënyra se si Islami e nxjerr njerëzimin prej botës së bestytnisë e të territ dhe e fut në atë të dijes e të dritës.

Prandaj, Islami është një fe praktike dhe nuk merret me kotësi e me teorizime boshe. Ai thotë se feja nuk është vetëm një deklaram i besimit, porse ajo është vetë motivi i jetës. Sjellja e drejtë dhe e ndershme duhet ta ndjekë besimin në All-llahun xh.sh. Feja është diçka që duhet të jetohet e jo lëndë e lajkës së thjeshtë. Kur’ani thotë:

⁷ G. B. Shaw, theksuar në *The Genuine Islam*, Singaporë, vëll. I, nr. 8, 1936.

“Lum për ata që besojnë dhe punojnë me drejtësi! Ata do të kenë një vendkthim të mirë, të bukur”, (Kur’ani, 13:29).

Kurse Muhammedi a.s. ka thënë:

“Zoti nuk e pranon besimin, në qoftë se nuk shprehet në vepra dhe nuk i pranon veprat, në qoftë se nuk përputhen me besimin”.

Që këtej, Islami është një fe e thjeshtë, racionale dhe praktike.

Uniteti i materies dhe shpirtit

Një tipar unik i Islamit është se ai nuk e ndan jetën në pjesë të qarta të materies e të shpirtit. Ai nuk e përkrah mohimin e jetës, por mbushjen dhe realizimin e saj. Islami nuk e mbështet asketizmin. Ai nuk kërkon prej njerëzve që t’u shmangen sendeve materiale. Ai mbështet faktin se ngritja shpirtërore mund të arrihet duke bërë një jetë të devotshme brenda rrëmujës së jetës e jo duke hequr dorë nga bota. Kur’ani na këshillon që të lutemi si vijon:

“Zoti ynë! Na jep në këtë botë të mirën dhe në botën tjetër të mirën dhe na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit (Xhehennemit)!”, (Kur’ani, 2:201).

All-llahu i qorton ashpër ata që refuzojnë t’i shijojnë begatitë dhe mirësitë e Tij. Kur’ani thotë:

“Thuaj (o Muhammed)! Kush i ka ndaluar stolitë e dhuruara prej All-llahut, të cilat Ai i ka krijuar për robërit e Tij, si dhe të mirat si mirësi për ju?”, (Kur’ani, 7:32).

Porosia islame është: “Hani e pini^{*}, por mos shpërdoroni me marrëzi e pa masë!”, (Kur’ani, 7:31).

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Muslimani që jeton në mesin e shoqërisë dhe me durim i bart vuajtjet që e godasin është më i mirë se ai që i shmanget shoqërisë dhe që s’e duron dot asnjë gabim që i bëhet”.

Ai ka thënë:

“Agjëro dhe prishe atë (pra, mos agjëro në ditë të caktuara) dhe qëndro në namaz e devotshmëri (gjatë natës) dhe fli, sepse trupi yt ka të drejtë mbi ty, syri yt ka të drejtë mbi ty, bashkëshortja jote ka të drejtë mbi ty dhe personi që të viziton ka të drejtë mbi ty”.

Në një rast tjetër ka thënë:

“Edhe këto tri sende janë pjesë e besimit:

- t’u ndihmohet të tjerëve, edhe nëse vetë je ngusht ekonomikisht,
- të lutesh me afsh për mirëqenien e gjithë njerëzimit, dhe
- të sillesh drejtë me vetveten”.

Prandaj, Islami nuk lejon kurrfarë ndarjeje midis jetës ‘materiale’ dhe ‘morale’, ‘mondane / shekullare’ dhe ‘shpirtërore’ dhe i urdhëron njerëzit që gjithë energjitë e tyre t’ia kushtojnë rindërtimit të jetës mbi baza të shëndosha morale. Ai i mëson ata se forcat morale dhe materiale duhet të shkrihen në njëra-tjetrën dhe se shpëtimi / lumturia shpirtërore mund të arrihet duke i shfrytëzuar burimet materiale për të mirën e njerëzimit në shërbim të qëllimeve të drejta, e jo duke bërë një jetë asketi ose duke u ikur sfidave të jetës.

* Fjala “pini” u referohet vetëm pijeve joalkoolike.

Bota ka pësuar mjaftë nga “njëanshmëria” e shumë feve e ideologjive. Disa sosh theksin e kanë vënë mbi anën shpirtërore të jetës duke i injoruar anët materiale dhe mondane të saj. Ato botën e kanë shikuar si një iluzion, mashtrim dhe kurthë.

Nga ana tjetër, ideologjitë materialiste tërësisht e kanë injoruar anën shpirtërore dhe morale të jetës dhe e kanë hedhur poshtë atë si fiktive dhe imagjinare. Të dyja këto qëndrime kanë shkaktuar një gabim fatal. Ato njerëzimit ia kanë grabitur paqen, kënaqësinë dhe qetësinë. Madje edhe sot ky zhbalancim po manifestohet në këtë apo atë drejtim. Dr. De Brogi, një shkencëtar francez, me të drejtë thotë:

“Rreziku i madh dhe i pashmangshëm i qytetërimit material i takon sërish vetë këtij qytetërimit; ky është një zhbalancim që do të rrjedhojë në qoftë se zhvillimi paralel i jetës shpirtërore nuk arrin ta sigurojë baraspeshën e duhur”.

Krishterizmi ka rënë në njërin ekstrem, kurse qytetërimit modern perëndimor me të dyja variantet e tij të demokracisë sekulare kapitaliste dhe të socializmit marksist, ka rënë në tjetrin. Sipas Lord Snell-it:

“Ne kemi ngritur një strukturë të jashtme të përpjesëtuar në mënyrë fisnike, mirëpo e kemi shpërfillur kërkesën qenësore të një rendi të brendshëm; ne me kujdes e kemi dizajnuar, dekoruar dhe pastruar anën e jashtme të kupës, mirëpo brendësia e saj ka mbetur përplot zhvatje e teprina; ne, dijen dhe fuqinë tonë të ngritur e ushtrojmë për të qeverisur mirëqenien e trupit, kurse shpirtin e kemi lënë të varfëruar”.⁸

Islami ka për qëllim vënien e një baraspeshe midis këtyre dy aspekteve – materiale dhe shpirtërore – të jetës. Ai thotë se gjithçka në këtë botë është për njerëzimin, kurse njerëzimi është për t’i shërbyer një qëllimi më të lartë: vendosjes së një rendi moral e të drejtë ku do të përmbushej Vullneti i Zotit. Mësimet e tij i kënaqin si nevojat shpirtërore ashtu edhe ato të përkohshme të njeriut. Islami kërkon prej njerëzve që ta pastrojnë shpirtin e tyre si dhe ta reformojnë jetën e tyre të përditshme – edhe individuale edhe kolektive – dhe të krijojnë epërsinë e së drejtës mbi fuqinë dhe të virtytit mbi vesin e shturjen. Prandaj, Islami qëndron pas rrugës së mesme dhe pas qëllimit për formimin e një njeriu moral që do të jetë në shërbimin e një shoqërie të drejtë.

3. Një mënyrë e tërësishme jete

Islami nuk është një fe që, në kuptimin e përgjithshëm e të shtrembëruar të fjalës, fushëveprimin e vet e mbyll dhe kufizon me jetën private të njeriut. Ai është një mënyrë e tërësishme jete, që u hyn në shërbim të gjitha fushave të ekzistencës njerëzore. Islami siguron udhëheqje dhe rrugëdalje për të gjitha fushat e jetës – individuale dhe shoqërore, materiale dhe morale, ekonomike e politike, juridike e kulturore, kombëtare e ndërkombëtare. Kur’ani kërkon prej njerëzve që të futen në grigjën e Islamit pa kurrfarë rezerve dhe ta ndjekin udhëzimin e Zotit në të gjitha fushat e jetës.⁹

Në të vërtetë, ka qenë një ditë e kobshme kur fusha e veprimit të fesë është mbyllur në jetën private të njerëzve dhe kur roli i saj shoqëror dhe kulturor është reduktuar në asgjë, në hiç. Mbase nuk ka patur faktor tjetër më të rëndësishëm që në epokën moderne ka shkaktuar rënien e fesë sesa strukja e saj në botën e jetës private, siç shihet edhe prej fjalëve të një filozofi modern:

⁸ Lord Snell, *The New World*, Londër: Watts & Co., f. 11.

⁹ Kur’ani, 2:208.

“Feja (me siguri aludon në Krishterizmin sh.p.) kërkon prej nesh që t'i ndajmë punët e Zotit prej atyre të Qesarit. Një ndarje e këtillë juridike midis këtyre dyjave nënkupton zvetënimin edhe të shekullares (sekulares) edhe të së shenjtës (sakrales)...dhe se feja është më e pavlefshme, në qoftë se ndërgjegjja e ndjekësve të saj nuk trazohet kur retë e luftës bijnë mbi gjithë ne dhe kur konfliktet industriale e kërcënojnë paqen dhe qetësinë shoqërore. Feja e ka ligështuar ndërgjegjen shoqërore dhe ndjeshmërinë morale të njeriut me ndarjen e punëve të Zotit nga ato të Qesarit”.

Islami tërësisht e denoncon këtë koncept të fesë dhe qartas thotë se synimet e tij janë spastrimi i shpirtit dhe rikonstruktimi i shoqërisë. Kur’ani thotë:

“Tashmë Ne me të vërtetë që kemi sjellë të dërguarit Tanë me tregues e prova të qarta dhe shpallëm me ta Shkrimet (Librat) dhe Peshoren (të drejtën) me qëllim që njerëzimi të mbajë drejtësinë. Ne e kemi zbritur edhe hekurin në të cilin ka forcë të madhe si dhe shumë përfitime për njerëzimin, me qëllim që All-llahu të provojë kush është ai i cili do ta ndihmojë Atë dhe të Dërguarit e Tij pa e parë Atë”, (Kur’ani, 57:25).

“Urdhri e gjykimi (në çështjen e adhurimit) nuk i takon kujt, pos All-llahut, e Ai urdhëroi të mos adhuroni tjetër, por vetëm Atë”, (Kur’ani, 12:40).

“(All-llahu i ndihmon) ata të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë, e falin namazin, japin zekatin, urdhërojnë për të mirë dhe largojnë prej së keqes. All-llahut i takon përfundimi i çështjeve”, (Kur’ani, 22:41).

Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Secili prej jush është mbrojtës apo bari dhe do të merret në pyetje për mirëqenien e grigjës së tij. Kështu, kryetari i shtetit do të pyetet për mirëqenien e popullsisë së shtetit. Secili burrë është bari në familjen e tij dhe do të përgjigjet për çdo anëtar të saj. Secila grua është bareshë në familjen e burrit të saj dhe do të japë llogari për çdo anëtar të saj. Dhe, çdo shërbëtor është bari për të zotin e tij dhe do të pyetet për pasurinë a pronën e të zotit”.

Prandaj, madje edhe një studim i përciptë i mësimave të Islamit tregon se ai është një mënyrë jetese gjithëpërfshirëse dhe se nuk lë jashtë asnjë fushë të ekzistencës njerëzore për t’u bërë fushë lojërash për forcat djallëzore.¹⁰

4. Baraspesha midis individit dhe shoqërisë

Një tipar tjetër i veçantë i Islamit është se ai vë një baraspeshë midis individualizmit dhe kolektivizmit. Ai beson në individin dhe çdokë personalisht e mban përgjegjës përpara Zotit. Ai i garanton të drejtat elementare të individit dhe nuk lejon që dikush t’i prekë e t’i nëpërkëmbë ato. Zhvillimin e drejtë e normal të personalitetit të njeriut Islami e konsideron si njërin ndër synimet parësore të politikës së tij arsimore. Ai nuk e mbështet mendimin sipas të cilit njeriu duhet ta humbë e shkrijë individualitetin e tij në shoqëri apo në shtet.

Sipas Kur’anit:

“Njeriu nuk do të ketë tjetër veçse atë për çka ka vrapuar (përpjekur)”, (Kur’ani, 53:39)

¹⁰ Për një studim akoma më të hollësishëm të aspekteve të ndryshme të mënyrës islame të jetesës, shih: Ebu’l-A’la el-Mewdudi, *Islamic Law and Constitution*, Lahorë: Islamic Publications Ltd., 1960; el-Mewdudi, *Islamic Way of Life*, Lahorë, 1967; Hurshid Ahmed, *Family Life in Islam* (përkthyer në shqip *Jeta familjare në Islam*), Lajçester: Islamic Foundation, 1974; Siddiki, M. N., *Some Aspects of the Islamic Economy*, Lahorë, 1970; Chapra, M. U., *Economic System of Islam*, Karaçi: University of Karachi, 1971.

“Dhe çfarëdo fatkeqësie që ju bie, ajo është veçse çfarë vetë duart tuaja e kanë fituar”, (Kur’ani, 42:30).

“All-llahu nuk e ndryshon (për të mirë apo për të keq) gjendjen e një populli, përderisa ai popull vetë nuk e ndryshon atë që ka në shpirt”, (Kur’ani, 13:11).

“Secili merr shpërblim për atë (të mirë) që ka fituar dhe (po kështu) secili merr dënim për atë (të keqe) që ka fituar”, (Kur’ani, 2:286).

“Ne kemi punët tona dhe ju tuajat”, (Kur’ani, 28:55).

Në krahun tjetër, ai gjithashtu e zgjon ndjenjën e përgjegjësisë shoqërore në njeriun, i organizon qeniet njerëzore në shoqëri dhe shtet, dhe kërkon prej individit që t’i mbështesë të mirat shoqërore. Namazi, në Islam, preferohet të kryhet në grup (me xhemat), gjë që ndër muslimanët e ngulit disiplinën shoqërore. Çdokush është i obliguar të paguajë zekatin, kurse në Kur’an theksohet se: “(Muslimanë janë ata që) në pasurinë e tyre kishin përcaktuar të drejtë për lypësin dhe për të ngratin (që ka nevojë, por nuk lyp)”, (Kur’ani, 51:19).

Xhihadi është një prej obligimeve fetare, çka nënkupton se individi duhet që, kur ta lypë puna, ta ofrojë madje edhe jetën e vet për mbrojtjen dhe ruajtjen e Islamit e të shtetit islam. Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Gjithë njerëzia është si një kope dhensh ku çdo anëtar duhet të jetë bari për tjetrin dhe të japë llogari për mbarë kopenë”.

“Jetoni së bashku, mos iu vërsulni njëri-tjetrit, lehtësojuani punët të tjerëve dhe mos nxirrni pengesa në rrugë të njëri-tjetrit!”.

“Nuk është besimtar ai që fle i ngopur, kurse fqinji i tij vuan urie”.

“Besimtar në Zotin është ai që nuk është i rrezikshëm për jetën dhe pronën e tjetrit”.

Shkurt thënë, Islami nuk e shpërfill as individin e as shoqërinë – ai krijon një harmoni dhe një baraspeshë midis të dyve dhe secilit ia cakton detyrat gjegjëse.¹¹

¹¹ Këtu ia vlen t’i kujtojmë fjalët e të ndjerit profesor H. A. R. Gibb që i ka thënë kohë më parë: “Brenda botës perëndimore Islami akoma e ruan baraspeshën midis të kundërtave të skajshme. I kundërt si me anarkinë e nacionalizmit evropian ashtu edhe me regjimentimin e komunizmit rus, ai (Islami) akoma nuk dorëzohet përpara atij pushtimi (obsesioni) me anën ekonomike të jetës që është karakteristike si për Evropën ashtu edhe për Rusinë e sotme. Etika e tij sociale me admirim është përmbledhur në fjalët e profesor Massignon-it: ‘Islami është meritë për përkrahjen e një koncepti mjaft barazimtar lidhur me kontributin e të dhjetës (*ushr, yshyr*) që çdo qytetar ia dhuron fondit të bashkësisë; ai qëndron kundër këmbimit të pakufizuar, kundër kapitalit bankar, kundër huave shtetërore, kundër taksave indirekte për sendet e nevojave elementare, mirëpo ai u përmbahet të drejtave të babait e të bashkëshortit, të pronës private e të kapitalit komercial. Këtu ai sërish zë një vend të ndërmjetëm midis doktrinave të kapitalizmit borgjez dhe të komunizmit bolshevik’.

Mirëpo, Islami akoma ka për t’i shërbyer kauzës së njerëzimit. Në fund të fundit, ai qëndron më afër Lindjes reale sesa Evropa dhe zotëron një traditë të rëndësishme të mirëkuptimit e të bashkëpunimit ndërracial. Asnjë shoqëri tjetër nuk ka regjistruar ndonjë sukses të këtillë në bashkimin në një barazi të statusit, të gjasës / mundësisë dhe të sjelljes së kaq shumë dhe kaq të ndryshmeve raca të njerëzimit...Islami akoma ka fuqinë t’i pajtojë elementet racore dhe tradicionale që haptas duken të papajtueshme. Sikur kundërshtimi e mosmarrëveshja e shoqërive të mëdha të Lindjes e të Perëndimit të zëvendësohej me bashkëpunim, ndërmjetësimi i Islamit do të ishte një kusht i pashmangshëm. Ai në shkallë të lartë ka dhe ofron zgjidhje për problemin me të cilin Evropa ballafaqohet në lidhje me Lindjen. Në qoftë se ato bashkohen, shpresa për një zgjidhje paqësore pa masë do të fitonte në vlerë. Mirëpo, në qoftë se Evropa, duke e refuzuar bashkëpunimin me Islamin, e hedh atë në krahun e rivalëve të saj, çështja për të dyja do të ishte vetëm shkatërrimtare e katastrofike”. H. A. R. Gibb, *Whither Islam*, Londër, 1932, f. 379.

5. Universaliteti dhe humanizmi

Mesazhi i Islamit është për mbarë racën njerëzore. Sipas Islamit, Zoti është Zot i gjithë botërave (Kur'ani, 1:1) dhe Muhammedi a.s. është peygamber për gjithë njerëzimin. Kur'ani a.sh. thotë:

“Thuaj (o Muhammed): ‘O njerëz! Vërtet që unë jam sjellë tek ju të gjithë si i dërguar i Allahut’”, (Kur'ani, 7:158).

“I lartësuar me madhësi qoftë Ai i Cili zbriti Kriterin e së Vërtetës (Kur'anin) te robi i Tij (Muhammedi a.s.) që të jetë këshillues për gjithë botërat!”, (Kur'ani, 25:1).

“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhammed) veçse si përkujtim mëshire për gjithë botërat”, (Kur'ani,21:107).

Në Islam, të gjithë njerëzit janë të barabartë, pa marrë parasysh ngjyrën, gjuhën, racën apo kombin. Islami i adresohet ndërgjegjes njerëzore dhe i flak tej të gjitha pengesat e rreme të racës, statusit dhe pasurisë. Nuk mund të mohohet fakti se pengesa të këtilla gjithnjë kanë ekzistuar dhe se ekzistojnë akoma edhe sot në këtë të ashtuquajtur epokë e ndritur. Islami i largon të gjitha këto pengesa dhe e proklamon idenë se gjithë njerëzimi është një familje e Zotit.

Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Të gjitha krijesat e Zotit përbëjnë familjen e Zotit dhe më i dashuri te Zoti është ai që më së shumti i do krijesat e Zotit”.

“O Zot! Zoti i jetës sime dhe i gjithçkaje në gjithësi! Pohoj se të gjithë njerëzit janë vëllezër të njëri-tjetrit!”.

“Respektoje Zotin dhe ki dashuri e dhembshuri ndaj familjes së Zotit!”.

6. Qëndrimi antiracist i Islamit

Islami është ndërkombëtar për sa i përket këndvështrimit dhe qasjes së tij dhe nuk pranon kurrfarë pengese apo ndarje të bazuar në ngjyrën, klanin, gjakun a territorin, dukuri këto që dominonin përpara ardhjes së Muhammedit a.s. dhe që në mënyrë të papërmbajtur e të shfrenuar vazhdojnë ta rëndojnë në forma të ndryshme madje edhe këtë epokë moderne. Ai dëshiron që mbarë gjininë njerëzore ta bashkojë nën një flamur. Një bote të përçarë nga rivaliteti dhe hasmëria nacionale, ai i prezenton një mesazh jete e shprese dhe të një ardhmërie madhështore.

Historiani Toynbee ka bërë disa vështrime interesante lidhur me këtë çështje. Në librin e tij *Civilization on Trial*, ai shkruan:

“Dy burimet e dukshme të rrezikut – njëri psikologjik e tjetri material – në relacionet e sotme të këtij proletariati kozmopolit (pra, të njerëzimit të perëndimuar / westernizuar) me elementin dominant në shoqërinë tonë moderne perëndimore janë: vetëdija racore dhe alkooli, kurse në luftën me secilën prej këtyre të ligave fryma islame mund të japë një shërbim që, nëse pranohet, do të kishte një vlerë të lartë morale dhe shoqërore.

Shuarja a zhdukja e vetëdijes racore, siç ndodh ndër muslimanët, është njëra prej të arriturave të dalluara morale të Islamit, kurse në botën bashkëkohore ekziston, ashtu siç duket, një nevojë e madhe për propagimin e këtij virtyti islam... Është e kuptueshme se fryma e Islamit mund të jetë një përforcim i dhënë në kohë të duhur, i cili do ta zgjidhte këtë çështje në favor të tolerancës dhe paqes.

Për sa i përket së keqes së alkoolit, ai është në shkallën më të përkeqësuar ndër popullatën primitive të vendeve tropikale të cilat janë “hapur” me anë të nismave e ndërmarrjeve perëndimore... Mbetet fakti që madje shumica e shtetarëve dhe politikanëve, si masa preventive të imponuara nga autoriteti i jashtëm, janë të paaftë ta çlirojnë një bashkësi nga një ves shoqëror, përderisa dëshira për çlirim dhe vullneti për ta bartur këtë dëshirë në një veprim vullnetar nuk zgjohen në zemrat e njerëzve në fjalë. Tani, administratorët perëndimorë, sidomos ata me origjinë “anglo-saksone”, shpirtërisht janë të izoluar nga lagjet “vendëse” për shkak të “dallimit racial” fizik që e ka shkaktuar vetëdija e tyre racore; konvertimi i shpirtërave të vendasve është një detyrë që vështirë se mund të pritët që kompetenca e tyre ta arrijë dot; dhe pikërisht në këtë pikë Islami mund ta luajë rolin e vet.

Në këto territore “të hapura” tropike, kohëve të fundit dhe në mënyrë rapide, qytetërimi perëndimor ka prodhuar një plenum ekonomik dhe politik dhe, në të njëjtën kohë, edhe një zbrazëtim shoqëror dhe shpirtëror...

Këtu, pra në planin e parë të së ardhmes, mund të shënojmë dy ndikime të vlefshme që Islami mund t’i shkaktojë proletarietit kozmopolit të shoqërisë perëndimore i cili i ka hedhur rrjetin gjithë botës dhe e ka përshkuar mbarë njerëzimin; kurse për një të ardhme më të largët mund të mendojmë për kontributet e mundshme të Islamit që mund t’ua japë disa manifestimeve të reja të fesë”.¹²

7. Qëndrueshmëria dhe ndryshimi

Elementet e qëndrueshmërisë e të ndryshimit bashkëjetojnë në shoqërinë dhe kulturën njerëzore dhe janë të detyruara të mbeten si të tilla. Shumë ideologji e sisteme kulturash kanë gabuar duke anuar rëndë kah njëri nga këto kënde (skaje) të barazimit. Theksimi i tepërt i qëndrueshmërisë, sistemin e bën të ngurtë e të shtangët dhe ia merr fleksibilitetin (lakueshmërinë) dhe përparimin, kurse mungesa e vlerave të qëndrueshme dhe e elementeve të pandryshueshme lind relativizmin, shturjen dhe anarkinë morale. Ajo që nevojitet është baraspesha midis këtyre të dyjave – një sistem që njëkohshëm do t’i kënaqë kërkesat e qëndrueshmërisë e të ndryshimit. Gjykatësi amerikan z. Justice Cardozo me të drejtë thotë se “nevoja më e madhe e kohës sonë është një filozofi që do të ndërmjetësojë midis kërkesave kundërshtarë për stabilitet dhe progres dhe që do ta vendosë parimin e rritjes e të zhvillimit”.¹³ Islami është një ideologji që i plotëson kërkesat si të stabilitetit ashtu edhe të ndryshimit.

Një përsiatje më e thellë tregon se jeta në vetvete përmban elemente edhe të qëndrueshmërisë edhe të ndryshimit – nuk është as aq e ngurtë dhe jofleksibile saqë të mos lejonte kurrfarë ndryshimi madje edhe në çështjet më të imëta, po as edhe aq fleksibile e fluide (e rrjedhshme) saqë tiparet dalluese të saj të mos kishin karakterin e vet të qëndrueshëm e të vazhdueshëm. Kjo bëhet më e qartë nga vëzhgimi i procesit të ndryshimit fiziologjik në trupin e njeriut: çdo ind i trupit ndryshon disa herë gjatë jetës së tij, mirëpo personi mbetet po i njëjti. Gjethet, lulet dhe frutat e një druri ndryshojnë, mirëpo karakteri i drurit mbetet i pandryshuar. Është ligj jete

¹² Arnold J. Toynbee, *Civilization on Trial*, Londër, 1957, f. 205-299 (shih gjithashtu f. 87-88).

¹³ Justice Cardozo, *Harvard Law Review*, 37, f. 279.

që elementet e qëndrueshmërisë e të ndryshimit duhet të bashkëjetojnë në një barazi të harmonishme. Të gjitha lakmitë e natyrës njerëzore dhe të gjitha nevojat e shoqërisë mund t'i kënaqë vetëm ai sistem jete që i mban dhe i kultivon të dyja këto elemente. Problemet bazore të jetës mbeten të njëjta për të gjitha moshat e brezat, mirëpo mënyrat dhe mjetet për t'i zgjidhur ato si dhe teknikat e trajtimit të dukurive pësojnë ndryshime me kalimin e kohës. Islami, në fokus sjell një perspektivë të re për këtë çështje dhe mundohet ta zgjidhë këtë në mënyrë realiste.

Kur'ani dhe *Sunneti* (rruga e Muhammedit a.s.) përmbajnë udhëzimin e përgjithshëm të dhënë nga Zoti i gjithësisë. Ky udhërrëfim vjen nga Zoti i Cili është i lirë nga kufizimet e “hapësirës” dhe “kohës”, ndaj edhe parimet e sjelljes individuale dhe shoqërore të shpallura prej Tij mbështeten në realitet dhe janë të amshueshme. Mirëpo, Zoti ka shpallur vetëm parimet e përgjithshme dhe i ka dhënë njeriut lirinë që t'i zbatojë ato në çdo shekull në mënyrë të përshtatshme me frymën dhe rrethanat e atij shekulli. Është pikërisht *ixhtihadi* (të menduarit e pavarur) ai nëpërmjet të cilit njerëzit e çdo shekulli mundohen ta implementojnë e vënë në praktikë udhëzimin hyjnor për problemet e kohës në të cilën jetojnë. Prandaj, udhëzimi bazor ka karakter të qëndrueshëm e të vazhdueshëm, kurse metoda e aplikimit të tij mund të ndryshojë sipas nevojave të veçanta të çdo shekulli. Kjo është arsyeja përse Islami gjithnjë mbetet i freskët dhe modern si mëngjesi i së nesërme.

8. Ruajtja e regjistrimit të tërësishëm të mësimëve

I fundit për nga radha, por jo edhe për nga rëndësia, është fakti se mësimet e Islamit janë ruajtur në formën e tyre origjinale dhe se Udhëzimi i Zotit është në dispozicion pa kurrfarë falsifikimesh e tjetërsimesh. Kur'ani është Libri i shpallur i Zotit, i cili ekziston që katërmëdhjetë shekuj dhe, si fjalë e Zotit, është ruajtur në formën e tij origjinale. Raportimet dhe transmetimet e hollësishme lidhur me jetën dhe mësimet e Pejgamberit të Islamit janë në dispozicion me pastërtinë e kulluar të tyre. Nuk ka patur asnjë thërrimë ndryshimi në këtë regjistrim të veçantë historik. Thëniet dhe gjithë regjistrimi i jetës së Pejgamberit a.s. na janë përcjellur e dorëzuar me përpikërinë dhe besueshmërinë e pashoq në veprat e *Hadithit* (thënieve të Pejgamberit a.s.) e të *Sires* (biografisë së tij). Madje edhe disa kritikë jomuslimanë e kanë pranuar këtë fakt të pamohueshëm. Profesori Reynold A. Nicholson në veprën e tij *Literary History of the Arabs* thotë:

“Kur'ani është një dokument tepër human që e reflekton çdo fazë të relacionit të Muhammedit me ngjarjet e jashtme të jetës së tij; kështu që në të kemi materiale të autoritetit të vetëm e të pakontestueshëm për gjurmimin e origjinës e të zhvillimit të hershëm të Islamit, materiale këto që s'i gjen dot as në Budizëm, as në Krishterizëm e as në ndonjë fe tjetër të lashtë”¹⁴

Këto janë disa nga tiparet unike të Islamit që ia japin atij mandatin për të qenë fe e njerëzimit – fe e sodit dhe e së nesërme. Këto aspekte i kanë joshur me qindra mijëra njerëz në të kaluarën dhe sot, dhe ua ka bërë me dije se Islami është fe e së vërtetës dhe e rugës së drejtë për njerëzimin; dhe kjo do të vazhdojë t'i joshë ata edhe në të ardhmen. Njerëzit me zemra të pastra dhe me përmallime të sinqerta për të vërtetën gjithnjë do të vazhdojnë të thonë:

“Deklaroj se s'meriton të adhurohet kush tjetër pos All-llahut, se Ai është Një, se autoritetin dhe sundimin nuk e ndan me askë; dhe deklaroj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij”.

¹⁴ Nicholson, R. A., *Literary History of the Arabs*, Kembrixh, f. 143.